

ZIHNI SAKO

EPIKA E LUFTËS NACIONAL ÇLIRIMTARE DHE E NDËRTIMIT SOCIALIST

Arkivi i Institutit të Folklorit disponon rreth 2000 tekste këngësh popullore të periudhës së luftës Nacional Çlirimtare dhe të periudhës së ndërtimit socialist të vendit. Në tërësinë e tyre, këto këngë, jo vetëm e kanë pasuruar, po e kanë kaluar epikën e të gjitha kohërave në një masë shumë të gjerë në sasi e në motive, duke pasqyruar kështu plotësisht revolucionin tonë demokratik popullor, i cili "nga gjerësia e pjesëmarrjes së shtresave më të gjëra të popullit tonë, nga niveli i ndërgjegjes së pjesëmarrësve dhe nga rezultatet e tij; nuk ka shok në historinë e lavdishme të Shqipërisë" (E. Hoxha — Raport në Kongresin e III të F.D.SH. — Tiranë 1955, f. 8).

Këngët e luftës Nacional Çlirimtare u krijuan në dy etapa. Në etapën e parë, e cila nis nga pushtimi fashist dhe mbaron më 29 nëntor 1944, ato u përftuan lidhur me ngjarjet luftarake të luftës Nacional Çlirimtare. Në etapën e dytë, që nis pas çlirimit, këto këngë lindën si evokim i heroikës partizane dhe lidhen me të kaluarën luftarake-revolucionare, me heroikën e punës për ndërtimin e socializmit dhe detyrat e mbrojtjes së atdheut dhe të pushtetit popullor.

Epika e luftës Nacional Çlirimtare u zhvillua në kushtet e luftës Nacional Çlirimtare, që u bë në kohëra dhe kushte të ndryshme nga luftat patriotike të së kaluarës për liri dhe pavarësi. Vazhda e përpjekjeve patriotike, që u zgjerua me elemente demokratike në vitin 1924, u gërshetua në periudhën e egër të sundimit të Zogut edhe me elemente të theksuara shoqërorë.

Lufta e dytë botërore ishte shpërthimi më i egër i imperializmit, në trajtën e vet më të avancuar të nazi-fashizmit, për të nënshtruar botën. Kjo luftë e gjeti vendin tonë, si viktimën më të parë, të pushtuar nga fashizmi italian qysh më 7 prill të vitit 1939. Prandaj epika e luftës Nacional Çlirimtare e gjeti këngën popullore në elementet e para të saj tradicionale-patriotike, në këngët elegjiake që vajtonin gjendjen fatkeqe të Shqipërisë, të shkelur nga pushtonjësi i huaj italian; Shqipërinë e gjeti në gjendje pushtimi përpara hyrjes së Bashkimit Sovjetik në luftë (21 qershor 1941), përpara themelimit të Partisë Komuniste Shqiptare (8 nëntor 1941). Për këtë arsye, epika e luftës Nacional Çlirimtare në etapën e parë të saj, u zhvillua në dy drejtime: në këngë patriotike të mirëfillta dhe në këngë shoqërore-politike të cilat ndoqën, plôtësuan dhe pasuruan njëratjetrën.

Megjithëse ushtarakisht e tradhëtuar dhe e çarmatosur, ekonomikisht e prapambetur dhe e raskapitur, më 7 prill 1939 Shqipëria nuk ishte në rënie morale. Qëndresa e kapter Mujo Ulqinakut me shokë u bë shëmbëll i lartë heroizmi dhe patriotizmi. Për këtë arsye edhe në këngët e para me karakter elegjak, që na flasin për "Shtatë prillin më të rirë" etj. vajtohet gjëndja e rëndë që pllakosi vendin, ku "bari e tërfili" u thanë, ku "s'këndon qyqja; as bilbili" dhe që na la pa dritë sa që "s'shësh njeriu njerinë", që na la pa bukë,

sa që "vdiqī foshnjërinë" që "flamurin e mbuloi zia", spikatin menjëherë edhe motivet tradicionale luftarake për të rrëmbyer armët, "sëpatat e hanxharët" për të luftuar për liri. Pra edhe në fillimet e veta epika e luftës Nacional Çlirimtare, në gjurmët e traditave, zhvillohet në plan liriko-epik.

Nga e kaluara populli ynë ruajti besnikërisht, si peng tepër të çmuar, një numur të madh këngësh popullore. Këngët epike të luftimeve të afërta, sidomos ato të shekullit të XIX-të, këngët patriotike të poetëve të Rilindjes dhe të çetave të viteve të dhjetvjeçarit të parë të shekullit të XX-të, me emrin e heroit legjendar, Skënderbeut, u bënë modele frymëzimi për improvizatorë të çuar e poetë. Ato ishin dëshmia kryesore e historisë së luftimeve të popullit tonë për liri dhe pavarësi shprehur në mënyrë artistike. Prandaj në kushtet e pushtimit fashist, evokimi i tyre u bë nëvojë e domosdoshme për të ushqyer dhe përgatitur popullin në drejtim të një prove tjetër akoma më të madhe e më të ndërjegjëshme. Kështu traditat, si në çdo kohë e në çdo rast, e ushqyen edhe këngën popullore të luftës Nacional Çlirimtare me elementet më të mira revolucionare dhe patriotike. Mbi këto shtresa tradicionale lindën dhe u zhvillua kjo krijimtari e madhe popullore, e cila i u përgjegj më së miri të gjitha ngjarjeve dhe fenomeneve luftarake, politike dhe shoqërore të luftës kundër fashizmit dhe nazizmit, e cila me forcën e saj poetike-heroike, me forcën e madhe agitative, ndihmoi pandërprerë rritjen e ndërjegjjes patriotike, rritjen e mobilizimit dhe të heroizmit të masave punonjëse për çështjen e çlirimit të atdheut.

1— Themelimi i Partisë Komuniste Shqiptare, luftës sonë patriotike; i dha, përkrah karakterit antiimperialist, edhe karakter revolucionar anti-feudal, e vunë edhe atë në koalicionin antifashist evropian. Në këtë gjendje të re epika e luftës Nacional Çlirimtare u pasurua me elemente të reja cilësore. Në bazën e saj ideologjike hynë principt e marksizëm-leninizmit, principtet themelore të Partisë Komuniste, me të gjitha kërkesat e saj për çështjen e lirisë, si të atdheut nga pushtimi i huaj, ashtu edhe të çlirimit të popullit nga zgjedha e brendëshme feudalo-borgjeze. Luftëtarët marrin një emër të ri : ata quhen "Partizanë" d.m.th. luftëtarë të çështjes së idealeve të Partisë. Partizanët, të edukuar e të brumosur me këto ideale, luftojnë për të situar "lirinë", po edhe për të çdukur "skllavërinë" për të dy klasat kryesore, për "punterinë" dhe "fshatarësinë". Kështu që këngët e luftës Nacional Çlirimtare i shërbyen në mënyrë të vetëdëshme parullave marksiste-leniniste të Partisë dhe qëllimit të revolucionit popullor, për të siguruar pushtetin popullor. Nga ky fenomen historik, që mbarte në zhvillimin e vet, elemente të luftës civile dhe elemente të revolucionit popullor krahos motivit patriotik, epika e luftës Nacional Çlirimtare trajtoi një motiv krejt të ri : aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë dhe këto këngë dhanë kështu një kontribut shumë të vlefshëm për forcimin e marrëdhënieve miqësore të këtyre dy klasave. Në këngën "Moj Parti t'u zënt'e mbara" na jepet një tabllë e qartë, tepër realiste e gjendjes së klasës punëtore para luftës dhe në kohën e fashizmit. Punëtorët, duke punuar "argatë" me "katër lekë" në ditë rrogë, s'kishin asnjë mundësi jetese. "Ylefeja" e tyre nuk ju siguronte jo vetëm gjellën, po as bukën. Punëtorët ishin pre e borgjezisë dhe feudalizmit. Me kërkesat e tyre do të bashkohej edhe fshatarësia, se edhe asaj "bejlerët e agallarët" i kishin zënë frymën, "u binin shpirtin në dhëmbë". Në përpjekjet e së kaluarës, fshatarësia punonjëse, duke mos pasur një aleancë të tillë "një të drejtë s'kishin parë". "Aftësia e partisë sonë qëndron në faktin historik se masën dërmuese të popullit shqiptar, fshatarësinë, jo vetëm e shpëtoi nga influenca e feudo-borgjezisë dhe e pengoi këtë që ta bënte fshatarësinë qoftë edhe për një çast rezervën e saj, po e bën këtë të kuptojë

që në fillim se çlirimi politik dhe ekonomik i saj dhe i vendit do të arrihej vetëm duke luftuar nën flamurin e Partisë sonë marksiste-leniniste, nën flamurin e klasës punëtore dhe vetëm në aleancë të ngushtë dhe nën udhëheqjen e klasës punëtore". (E. Hoxha: Fjalim me rastin e 15 vjetorit të çlirimit — Tiranë 1959, f. 9) Prandaj ata u bashkuan në një rrugë: në atë rrugë që i thirri Partia. Në këtë mënyrë këto elemente të shtypjes shoqërore, që buronin nga protestat e hershme kundër shtypjes, kënga popullore e luftës Nacional Çlirimtare, duke i trajtuar në një plan tjetër ideologjik, i trajtoi pra edhe në një plan tjetër artistik. Karakterit përshkrues të vuajtjeve në të kaluarën, u dha herëkëmbë revolucionare për kërkesa të caktuara, siç u përmënd më lart: për puntorinë dhe fshatarësinë. Këto ndryshime cilësore erdhën si rezultat i principeve të marksizëm-leninizmit të Partisë sonë në çështjen e çlirimit nacional dhe shoqëror të punonjësve të qytetit dhe të fshatit.

"Merita më e madhe e partisë sonë që kondicionoi kurorëzimin me sukses të revolucionit popullor që fakti se ajo, e udhëhequr nga mësimet e pavdekshme të Marksit-Engelsit-Leninist dhe Stalinit dëjti të krijojë dhe të çelni-kosë aleancën e shëndoshë midis klasës punëtore dhe fshatarësisë, nën udhëheqjen e klasës punëtore, si forcën vendimtare të revolucionit tonë demokratik popullor" (E. Hoxha: Raport mbi aktivitetin e K.P. dhe detyrat e mëtejshme të F.D. — në Kongresin e III-të të F.D.Sh. — Tiranë 1955, f. 9).

Këtë çështje pra epika popullore e luftës Nacional Çlirimtare e ka pasqyruar në një numur të madh këngësh.

2. — Partizanët, të ardhur në pjesën dërmuese nga klasa punëtore dhe fshatarësia punonjëse, duke tërhequr në rrugën e tyre revolucionare edhe një masë të gjërë patriotësh, duke gjetur rrugën e shpëtimit të Partia, e situatën efektive të ushtrisë partizane vullnetare nacional çlirimtare në një masë mjaft të rëndësishme, relativisht me popullatën, 70000 vetë midis të cilëve 6000 gra.

Ushtria partizane e udhëhequr nga Partia, me themelonijsin dhe organizatorin e saj në krye, shokun Enver Hoxha, "ilegal, bombat në trastë — malit me ditë me natë", bëri një varg të madh lufttrash heroike. Komunistë dhe pa parti përfaqësojnë në mënyrë të denjë Partinë e tyre. Duke "u futur në top", duke "u futur në murtajë", këta "djem fërtunë", "me dufeqe nënë gunë", "të gjithë të zgjedhur, të gjithë vullnetarë", kudo që shkojnë "çlirojnë vatanë". Sado që edhe në përshkrimin e ngjarjeve kënga popullore e luftës Nacional Çlirimtare, ruan me besnikëri karakterin tradicional, ajo ka fituar, për vetë faktin e qëllimeve të reja të luftës edhe nota trajtimi dhe përdorimi të ri të figurave tradicionale. Ashtu si në këngët e luftës së Vlorës, kur vullnetarët "i mbanin fyshekët në xhep" e "dyfekët lidhur me gjalmë" edhe partizanët "me opinga prej lëkure", "me bomba e sakurate" kanë një afëri logjike, janë pasardhës të denjë të një gjaku. Po "bumjet e Kajanit" ushtojnë më shumë se "topat e gjermanit". Prandaj figura epike e partizanit qëndron në një lartësi më të madhe shpirtërore, mbasi ai lufton në kushte të tjera, por më ideale më të përpunuara, lufton në kushte armatimesh të reja: me tankun, autobлиндën e murtajën "krismë thatë". Qëllimi i lartë i çështjes së Partisë dhe popullit i bën partizanët tepër të vetëdijshëm për vendosmërinë e tyre. Duke shpënë akoma përpara traditat trimërore të të parëve, fuqia e tyre politike është rritur në cilësi. Në këtë mënyrë këngët popullore i pasuruan elementet e hershme me elemente të reja. Figura e partizanes Mali Pipa, është një përgjithësim i shkëlqyer epik. Ajo "nuk u trëmb nga plumbat", "nuk i druajti armiqtë", po u derdh kryelartë midis tyre. Sulmi i saj të kujton figurën e Rapo Hekalit, i cili, edhe pse "plum-

bat i binin mbi supe", "as u trëmb e as u tut". Kënga për Mali Pipën sjellë në këngëa popullore një element të ri : "flamurin e kuq", të cilin partizanja Mali e kujton dhe ngrë grushtin për ta nderuar, edhe kur "plumbat e armiqve i merr në trup". Elementi i ri kualitativ, në këtë rast, është ideali i saj : komunizmi.

3— Tema e epikës së luftës Nacional Çlirimtare është shumë e gjerë. Lufta Nacional Çlirimtare u bë në miqësi me popujt e Bashkimit Sovjetik. Kështu, ndryshe nga e kaluara, kur populli ynë në luftat e tij për liri dhe pavarësi, nuk pati asnjë mbështetje miqësore e të sinqertë nga popujt tjerë, kësaj radhe ai pati një ndihmë dhe mbështetje miqësore të Bashkimit Sovjetik, të udhëhequr nga J.V.Stalini. "Për herë të parë në historinë e tij populli ynë i vogël gjeti një mik të sinqertë në popullin e madh sovjetik, që i donte të mirën, që luftonte për të mirën e tij, për çlirimin e tij, për sigurimin nga ana e tij e një të ardhmeje më të lumtur. Farkëtimi i miqësisë së madhe dhe i dashurisë së sinqertë për Bashkimin Sovjetik, shpëtimtarin dhe mbrojtësin e popullit tonë dhe të fitoreve të tij, ishte një nga konditat kryesore të fitores së popullit tonë mbi fashizmin". (E.Hoxha : Raport në Kongresin e III të F.D.SH — Tiranë 1955, f.14). Miqësia buron nga ndjenjat e internacionalizmit proletar, një nga principet themelore të marksizëm-leninizmit. Kënga popullore e luftës Nacional Çlirimtare e përvetësoi këtë princip dhe e trajtoi, duke e pasuruar epikën heroike shqiptare me një motiv krejt të ri : internacionalizmin proletar, element i cili, i frymëzuar nga politika marksiste-leniniste e Partisë, e bëri epikën tonë pjesëmarrëse aktive në çështjen e çlirimit edhe të popujve të tjerë. Luftat heroike të divizioneve V e VI S. partizane shqipëtare në tokat e Jugosllavisë janë një temë, që ka gjetur jehonë në mjaft këngë si fjala vjen në ato për luftat në Drinso e Vishegrad. Populli ynë ka një traditë të shkëlqyer në drejtim të veprimeve luftarake për lirinë e popujve të tjerë. Skënderbeu u bë mburojë e çelniqtë për një çerek shekulli për Evropën nga invadimi turk. Ali Farmaqi nga Llalla, mik i Kollokotronit dha në vitet 1806-1810 një kontribut të vlefshëm për lirinë e Greqisë. Populli ynë, duke qenë popull i etur për liri, ka ngritur këngë edhe për luftën e boerëve, më 1908. Këto tradita Partia jonë, e frymëzuar dhe e udhëhequr nga idetë e marksizëm-leninizmit, i organizoi e i çoi akoma më përpara. Sado larg, populli ynë i ka kënduar luftës së popullit korean, luftës për kanalin e Suezit, duke i shërbyer kësisoj, çështjes së luftës së përbashkët kundër imperializmit. Kënga popullore, duke i fiksuar këto ngjarje, ka sjellë një kontribut mjaft të vlefshëm në forcimin e miqësisë midis popujve. Prandaj, në këtë drejtim, epika e jonë e luftës Nacional Çlirimtare nuk përtëriti thjesht trajta poetike dhe shprehje afeksioni për çështjen e lirisë, po ajo u pasurua e u zhvillua në një diapazon më të gjerë mendimesh dhe ndjenjash, mbasi me fjalën e saj artistike zgjon vigjilencën dhe ngrë lart luftat e drejta.

Fryma antiimperialiste e këngës popullore u gërshetua dhe u forcua akoma më shumë me motivet e luftës kundër diversionit revizionist. Partia e Punës së Shqipërisë kurdoherë ka qëndruar në pozitën e shëndosha të ideve të marksizëm-leninizmit. Ajo nuk është pajtuar me asnjë çfaqje atomariste. "Një rrezik serioz për unitetin e kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, për çështjen e paqes e të çlirimit të popujve, përbën grupi tradhëtar revizionist i Titos, që është repatri më agresiv e më i rrezikshëm i revizionizmit të sotëm ndërkombëtar, një agjenturë e rregjur e imperializmit, në radhë të parë e imperializmit amerikan. Partia jonë e Punës ka bërë kurdoherë një luftë të vendosur kundër pikëpamjeve dhe veprimtarisë armiqësore të revizionistëve të Beogradit, duke e konsideruar këtë luftë si kusht të domos-

doshëm për mbrojtjen e interesave të atdheut tonë, për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, për forcimin e unitetit dhe të kompaktësisë së kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, për zhvillimin me sukses të luftës kundër imperializmit dhe për ruajtjen e paqes. Ajo e ka quajtur dhe e quan këtë luftë si detyrën e saj të lartë internacionaliste". (E.Hoxha : Raport në Kongresin IV të P.P.Sh. — Tiranë 1961, f.149-50). Prandaj e ka luftuar dhe po e lufton me këmbëngulje dhe heroizëm revizionizmin, si shërbëtoreshë direkte të imperializmit skllavëronjës. Duke përkrahur luftën aktive të komunistëve marksistë-lininistë, duke përkrahur luftën për çlirimin nacional të vendeve koloniale, ajo kryen me nder detyrën e saj të internacionalizmit proletar. Këngët popullore të viteve pas çlirimit e kanë trajtuar gjerësisht luftën kundër diversionit revizionist, veçanërisht atij jugosllav. Kështu elementet e internacionalizmit proletar u shprehën qartë edhe në këngët për Memo Nexhipin, që u vra në provokacionin e gushtit të vitit 1949, për Xhemal Tafën, Avdul Merkon, Tom Kolën, Zenel Kadrinë, Nuri Luçin, Ndreç Nue Gjokën, Ram Sadrinë e të tjerë. Ato janë një dëshmi e gjallë e ndjenjave patriotike, për mbrojtjen e interesave të atdheut dhe të socializmit, janë shprehja e gjallë e detyrës tona internacionaliste, kundër imperializmit dhe revizionizmit. Kënga "Tash ju hoq peta loknorit", që flet për tradhëtinë e Teme Sejkos me shokë, demaskon imperializmin amerikan, revizionistët jugosllavë dhe monarko-fashistët grekë, të cilët komplotojnë kundër popullit tonë, paqes, dhe popujve revolucionarë e lirishtës, që luftojnë për çlirimin kombëtar kundër forcave të imperializmit dhe neokolonializmit.

4— Gjatë luftës Nacional Çlirimtare ranë heroikisht 28000 partizanë e partizane. Përkujtimi i tyre zë vëndin kryesor në këngët popullore, duke shprehur mirënjohjen e thellë kundër tyre, të cilët, në lulen e rinisë, dhanë gjënë më të shtrënjtë, jetën. Po kjo dhëmbje s'është më një shprehje e ngushtë individualiste, si te elegjitë për nizamët ose për kaçakët, humbja e të cilëve ishte një gjëmë e pashërueshme për familjen. Ajo është një dhëmbje e përgjithëshme, kombëtare, pra si e tillë del nga kuadrin e thjeshtë familjar. Karakteri i përbashkët, përgjithëshues, u sjell elegjive partizane ndryshime rrënjësore, të cilat burojnë nga detyra për të zgjidhur një çështje të përbashkët. Në to nuk sundon më pesimizmi, po krenaria. Në elegjinë "T"ju këndojmë trimave" ku, me një forcë të mrekullueshme realiste, tregohet se përtizanët, duke "fjetur lëndinave", duke "pasur dyshek tokën", "gunat jorgan" e "shpellat shtëpi", dhëmbja për vuajtjet e tyre ngrihet në një pathos epik, që rrallëherë mund të gjëndet në letërsinë popullore botërore. Në vijën e parë elegjake të saj qëndron mendimi i madh, frymëzimi patriotik i luftës çlirimtare. Ata kanë "vëllezër fishekët", "bombat i kanë për sulm"; rrugën për këto përpjekje të rënda e kanë zgjedhur "për lirinë" se "robërinë nuk'e duan". Pra përmbi vuajtjet qëndron një xhest shumë i lartë dhe ky xhest, lufta për çlirim, i jep këngës një rritje cilësore epike mbi vijën e parë të saj elegjake. Pothuaj në të gjitha këngët me karakter elegjak për partizanët dhe partizanet që ranë në luftë, gjejmë këtë notë që mbizotëron : Misto Mamja, kur vritet heroikisht i lë puntorisë "botën e re" ; Balil Peçi e bën veten thëror "për lavdinë e Partisë", për çlirimin e atdheut, "për të drejtën, të vërtetën". Nëna shqiptare në vajet e saj ngrihet përpara dëgjuesëve të ligjeve të saj si heroinë, se këta bij e bija të vranë "i kish rritur për botën e re". Ky karakter epiko-heroik i këngëve për partizanët e vranë shkon gjithmonë duke u pasuruar edhe më shumë në këngët për rojet kufitare, për punonjësit e sigurimit, që bien në luftë kundër diversionit revizionist. E ëma e nëntoger Ram Sadrisë, përpara trupit të të birit Ramës, e ngrohët si nënë, trime si shqipe,

që lind burra të tillë, në lotët e saj përshëndet Shqipërinë e re, për të cilën ranë të parët e Ramës, që vajtoi shoqja e saj në luftë.

Në këtë drejtim ligjet e herëshme për shokët dhe shoqet partizane i a lanë vendin një elegjie, në të cilën shtjellohet dhëmbja optimiste. Këtu, pra, kemi një ndryshim tjetër cilësor nga epika e së kaluarës, si rezultat i drejtësisë së vijës së përgjithëshme politike të Partisë sonë.

5 — Një temë e re për këngët popullore të luftës Nacional Çlirimtare janë evenimentet e rëndësishme historike të Partisë. Nga epika e së kaluarës edhe në këtë drejtim kemi një farë trashëgimie, e cila, sado e vogël që të jetë tregon se kënga popullore ka lujtur një rol edukues, duke parë qartë rëndësinë e madhe në çështjen kombëtare. Kënga e vitit 1770 për pajtimin e të krishterëve me myslimanët, kënga për mbledhjen e Povelës në kohën e kryengritjeve fshatare kundër tanzimatit, kënga për mbledhjen e Gjirokastrës në kohën e Lidhjes së Prizrenit, janë çështje të një rëndësie të dorës së parë përpara tyre. Kuptohet që kënga popullore nuk mund të qëndronte inaktive, prandaj edhe këto këngë kanë vlerë të madhe historike. Po gjatë luftës nacional-çlirimtare ky element, nga karakteri i hershëm deskriptiv, merr një karakter programatik dhe mobilizonjës. Ai shpreh në vetvehte një konkretizim të idealeve, prandaj në trajtimin realist të kësaj teme, edhe në këtë rast, ndjehet një optimizëm i thellë, prandaj roli mobilizonjës është shumë më i madh. Ngjarjet politiko-organizative janë të shumta, për këtë arsye edhe numri i këngëve në këtë drejtim është relativisht i madh. Këngë të përmendura për evenimente të tilla, tepër të rëndësishme për çështjen e popullit dhe të atdheut, janë ato për themelimin e Partisë, për Konferencën e Pezës, për Kongresin e Përmetit, për krijimin e Këshillave Nacional Çlirimtare, për mbledhjen e Poçemit, për Kongresin e parë të Partisë, për shpalljen e Republikës, për zgjedhjen e deputetëve, për Konferencën e Paqes e të tjera. Siç shihet, në tërësinë e me mënyrën e tyre, edhe këto këngë kanë shprehur karakterin popullor të luftës Nacional Çlirimtare dhe të pushtetit. Po ato nuk janë thjeshtësisht krijime spontane të një entuziazmi momental: ato janë hove të sinqerta, të gjalla dhe tepër aktive në dobi të forcimit të çështjes së Partisë, popullit dhe të atdheut. Këto evenimente lidhen ngushtë me vetë zhvillimin e luftës Nacional Çlirimtare, me ndërtimin e socializmit, me realizimin e aspiratave dhe qëllimeve për të cilat u bë lufta. Themelimi i Partisë, që një ngjarje vendimtare për drejtimin e përgjithshëm të revolucionit popullor. Enver Hoxha, sipas një kënge popullore, e kishte bërë planin e luftës qysh në vitin 1940. Prandaj ai u drejtohet shokëve "si do bëjmë ne nashti?". Këtu është fjala për proporcionet që po merrte lufta e dytë botërore dhe rritjen e rezistencës së popullit shqiptar. Këtu është fjala për luftën e shokut Enver Hoxha, për mbledhjen e grupeve komuniste, për formimin e Partisë. Kënga popullore, vëzhgonjëse besnike dhe tepër realiste e ngjarjeve, dinte më së miri të dalloste dhe të vendoste vijën e kufirit midis së mirës dhe së keqes. Ajo e shikon qartë se "Enver Hoxha mendoi për Shqipëri" duke "formuar në Tiranë një Partë". Evenimentet e tjera politiko-organizative janë realizimet e njëpasnjëshme të politikës së Partisë. Kështu në Konferencën e Pezës shoku Enver me shokë të tjerë "dhanë fjalë benë benë — të shpëtojnë mëmëdhenë". Në Kongresin e Përmetit ku "u hoq zgjedha se na shoi" kënga popullore ka fiksuar epokën e re të pushtetit popullor, që po i vinte kapak të kaluarës së hidhur, shtypjes dhe skllavërisë së jashtëme dhe të brendëshme dhe që do të hapte rrugën ndërtimit socialist. "Kongresi i Përmetit nati një rëndësi të jeshhtëzakonëshme, që do të mbetet si një datë e shënuar në historinë e popullit tonë. Ai ishte një Kongres kushtetues. Ato rezultate që u arritën me aqë gjak, me aqë vuajtje, duhej të saksio-

uoheshin nga populli ynë heroik dhe sovran" (E. Hoxha, Fjala në XX vjetorin e Kongresit të Përmelit). Duket pra qartë se çdo këngë popullore, ka fiksuar më së miri karakteristikat themelore të secilës ngjarje. Në këtë mënyrë kënga popullore u është përgjegjor menjëherë cilesdo ngjarje dhe qëndron mbi të si një lapidar.

6 — Populli ynë historinë e tij e ka të mbushur me lufta të përgjakshme për liri dhe pavarësi. Po kurdoherë frutet e gjakut të derdhar e shkonin kot. Mbi të qëndronin përsëri si male kapitalet e huaja, një grusht njerëzish të klasave shfrytëzuese, që bashkoheshin me armikun si në kohë luftime ashtu edhe në kohë paqe. Shumë këngë popullore të së kaluarës na japin me figura të gjalla gjendjen e mjerruar të pupullit bujkut "i grinte këmbët ugari", mërgimtarit në dhe të huaj, për një kafshore bukë: "futej dyqind pash litar nën dhe". Kësaj gjëndje i vuri kapak fitorja e luftës Nacional Çlirimtare më 29 nëndor 1944. Në këto njëzet vjet Shqipëria e prapambetur, me 80% analfabetë, po transformohet me ekonominë e vet socialiste në një shtet industrialo-agrar. "Kushtet vendimtare — ka thënë shoku Enver — për zhvillimin e vëndit në rrugën e socializmit u krijuan që në nëndor të vitit 1944, kur, pas triumfit të revolucionit popullor, u zgjidh detyra e tij strategjike kryesore: pushteti politik kaloi përfundimisht në duart e klasës punëtore dhe të masave punonjëse, të udhëhequr nga Partia". Në këtë gjëndje të re edhe kënga popullore, duke përvehtësuar dhe trajtuar të gjitha ngjarjet, ka lojtur një rol të rëndësishëm në rritjen morale të vrullit patriotik të punonjësve në punë. Tani pathosi epik revolucionar i këngës së luftës Nacional Çlirimtare, si një pjesë përbërëse dhe tepër e rëndësishme edhe për këngën e re, u shndërrua në një pathos, në qëndrën e të cilit qëndron puna për ndërtimin socialist. Po për arsye të kushteve speciale të ndërtimit tonë socialist në rrethimin e dyfishtë imperialist e revizionist, këngët e pasluftës, nën ndikimin dhe frymëzimin e parullave marksiste-leniniste të partisë e drejtojnë aktivitetin e agitacionit të tyre drejt mobilizimit për punën transformuese, drejt mbrojtjes së vëndit me armë në dorë, element, që siç u tha më lart, herë shtjellohet në një ngjarje të caktuar luftarake, herë lidhet organikisht me elementet e reja që trajton kënga e punës.

Temat e epikës së periudhës së pas çlirimit, nuk janë një pasurim i temës tradicionale; ato janë tema të reja, pra kemi të bëjmë me një krijimtari të re. Karakteristikat dhe veçoritë e një vëndi socialist i krijojnë mundësi të mëdha zgjerimit të horizontit kultural popullor, pra edhe folklorit. Lulëzimi i folklorit tek ne është një fakt bindës, se folklori nuk është një aktivitet kultural që i përket vetëm të kaluarës, që ka pushuar së zhvilluari nën presionin e industrisë dhe arësimit.

Në këngët e pasluftës flitet për punën vullnetare në rrugën e Dritës, në bekurudhën Durrës-Peqin, flitet për fabrikat, hidrocentralet, për kolektivizimin e tshatit, për punën në miniera, për planet pesëvjeçare etj. Të gjitha këto janë kryesisht tema që i përkasin të tashmes së këtyre njëzet vjetëve. Arsëvet e krijimeve krejtësisht të reja janë, se rendi socialist krijoi mundësitë e kalimit të mjeteve të prodhimit nga duart e pakicës shfrytëzuese në duart e shumicës së shfrytëzuar. Në vëndet kapitaliste ku sundon prona private e kapitalistëve, puna dhe fabrika nuk i jep punëtorit asnjë gëzim, pra nuk i nxit asnjë dëshirë që t'u këndojë. Prandaj n'ato vënde folklori ka mbetur në një gjëndje të pazhvilluar.

Këngët e pasluftës Nacional Çlirimtare janë një thirrje gazmore dhe optimiste, mbasi "ndërtimë botën e re" që të "rrojmë të lumtur". Optimizmi i këngës për jetën e re, shpiehet në punën e palodhur e frytëdhënëse, kolektive, në besimin dhe vendosmërinë për Socializmin, që "ne na troket në derë".

7 — Kënga popullore, si një veprimtari shoqërore, ka karakter klase. Elementet e këtij karakteri duken edhe në mjaft këngë të së kaluarës. Ato kanë shprehur luftën e vendosur kundër të huajve, kanë shprehur herëherë, në mënyrë spontane, urrejtjen edhe kundër shtypjes së brëndëshme. Të tillë janë motivet që trajtojnë këngët. "Rrapi Lelos dega tëndë", "O xhandar; o mëngë gjerrë", "u zunë pleqtë me hejné", "Halil Gashi", kënga për Myrto Fjanin nga Kraja e Shkodrës, kënga për grevën e kundraxhive në Shkodër etj. Këto elemente shoqërore zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme krahas zhvillimit të luftës së vetëdëshme që bëjnë masat punonjëse kundër shtypjes feudalo-borgjeze. Me përhapjen e ideve komuniste, veçanërisht me konkretizimin e tyre në mënyrë shkencore ku themelohet Partia Komuniste Shqiptare, ideja e luftës së klasës forcohet akoma më shumë dhe në tërësi epika e luftës Nacional Çlirimtare e drejton tehmën e saj në forcimin e ndërgjegjës revolucionare për çlirimin e masave të gjera punonjëse nga zgjedha e dyfishtë: imperialiste dhe zgjedha e brëndëshme e koncentruar në grupet kolaboracioniste, që përbëhesh nga qeveritë e njëpasnjëshme kuislinge, nga grupet e Ballit të Legalitetit. Disa prej këngëve të epikës së luftës nacional-çlirimtare, ka raste që tregojnë elemente të theksuara kundër shtypjes shoqërore, si kënga për punëtorët në shoqërinë Purigeli, kënga për demaskimin e Ali Këlcyrës, Mustafa Krujës, kënga "Abaz aga don me ardhë", kënga "Ç'ka po thot balli kombëtar . . .", të cilat nga satira kalojnë në një sarkazëm, të fuqishëm, ku del në pah akoma më shumë urrejtja kundra feudalizmit dhe borgjezisë. Herëherë këto elemente në trajtë antiteze shtjellohen së bashku me ngjarje të tjera, si të këngët "Shpëtimtare qe Partia", "Rrofsh Parti ku na mbështete", "Na tregon plaku ca derte", "Shqipeja me nam të lartë", "Na u çduknë fajdexhitë", "O kulak, i mjeri kulak" etj. Trajtimi i këtyre motiveve ndihmon edukimin e ndërgjegjshëm të masave punonjëse për t'u mbyllur rrugët armiqëve të klasës që duan të restaurojnë të kaluarën.

Si këto këngë ashtu edhe ato për ngjarjet luftarake kundër pushtonjësve fashistë, kundër imperializmit dhe revizionizmit, janë pra tipike e shprehjes së karakterit klasist të folklorit.

8 — Këngët e luftës Nacional Çlirimtare dhe të pas luftës u pasuruan me një tematikë të gjerë dhe të gjithanëshme, për arsye të karakterit të gjerë popullor të vetë luftës dhe revolucionit popullor. Nga ana tematike ato i përkasin epikës qytetare. Qartësia politike, brendia e shëndoshë e tyre, forca epike e tyre janë pasqyrimi i drejtpërdrejtë i ideologjisë marksist-leniniste të Partisë. Duke i treguar popullit qëllimin e revolucionit, Partia i ndriçoi mendjen dhe i formoi vetëdijen. Prandaj, në qendër të vëmendjes së saj ka Partinë. Ajo u frymëzua krejtësisht nga idetë e Partisë; pra fitoi një cilësi krejt të re nga epika e së kaluarës: partishmërinë. Kjo karakteristike nuk dallohet vetëm në këngët e ngritura direkt për të, po në tërësinë e tyre. Në këngët popullore të luftës dhe të pas luftës Partia na mësoi "me kap mauzeren", "me i kall barot anmikut", "të japim jetën", për "vatan e idet e saj"; ajo "na mëson si me punue", e "si vendim me e ndërtue". "Për Partinë shqipe mali" këndon zemra shqipëtare se asaj, "në tan botën i ka vojt zani" mbasi asnjëherë "s'u tund nga istikami", nga pozitë e marksizëm-leninizmit triumfonjës.

Partia lindi në mes të zjarrit dhe të furtunës, ajo hyri si dritë shpëtimtare në çdo zemër të punonjësve shqiptarë. Ajo nuk është një ide fiktive, ajo është një forcë materiale që jeton, rritet dhe zhvillohet bashkë me popullin. Në prozopopenë e bukur të kënga "Për të dashurën Parti" ajo, në male kudo, ka hequr me popullin bashkë, "me qull e bukë në hi", duke pasur "fyshekët

dhe bombat në gji" luftoi trimërisht "me dy mbretëri". Te Partia kënga popullore shikoi vendosmërinë dhe besimin e patundur për fitoren mbi armiqtë. Ajo i rriti popullit fuqinë morale; "mos u trëmbni, do ta heth". Me këtë varg te kënga "Partia po na mbëleth" improvizatori i talentuar, i rritur edhe ky në gjirin e partizanëve, ka parë qartë optimizmin dhe triumfin e diskutueshëm të përpjekjeve popullore të udhëhequra nga Partia, e cila, duke triumfuar mbi fashizmin, duke "unjur shkallën e lartë", triumfoi edhe mbi feudo-borgjezinë e i hapi popullit rrugën e fitoreve socialiste, të bollëkut, "që pat prit Shqipnia" nëpër shekuj.

Partia, si një forcë materiale, që e çon popullin përpara lidhet në mënyrë organike me rolin e udhëheqjes. "Asnjë klasë në histori nuk e ka arritur sundimin, pa nxjerrë udhëheqësit e saj politikë, përfaqësuesit përparimtarë të aftë të organizojnë lëvizjen dhe ta udhëheqin atë" (Lenin. Vepra — IV f. 432). Kështu klasa punëtore dhe fshatarësia punonjëse në krye të udhëheqjes së Partisë, detashment pararojë i organizuar dhe i ndërgjegjshëm i klasës puntore, nxori shokun Enver Hoxha, që e themeloi, e organizoi atë dhe e çoi përpara në fitore të njëpasnjëshme.

Një numur i madh këngësh i dedikohen shokut Enver. Enver Hoxha, në krye të partisë, si partizanët "ilegal bombat në trastë", "pa buk'e pa ujë farë", e udhëhoqi popullin në luftën e tij çlirimtare dhe duke sulmuar "më çdo zonë e më çdo anë" si "trem, si rrafë" "e ndoqi këndej dushmanë" e bashkë me ta "Ballin me ballistat, që mirrë çuje". Ai e lidhi Shqipërinë me "illin me pesë cepe" që e çpiku Lenini i parë. Enver Hoxha ndërtoi pushtetin popullor; shpëtoi Partinë dhe Republikën tonë popullore nga imperialistët dhe revizionistët e çdo kallëpi, ai "ish e do jetë në ballë" në këtë luftë të vendosur për mbrojtjen e Partisë, për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Enver Hoxha, që luftoi "me dyfek e me granata" për çlirimin e Shqipërisë, ai udhëhoqi popullin dhe në ndërtimin socialist. Partia dhe Enver Hoxha janë një dhe të pandarë. Me ta lidhet ndërtimi i fabrikave, i kolektivizimit, i kulturës së re socialiste dhe, duke pasur "në krye Partinë e Enverë", "Shqipëria nuk është më si njëherë.", ajo "s'asht ma tokë pazot", se ne "kemi Enverë e Partinë" që kanë dalë nga gjiri i popullit.

Siç shihet pra, epika e luftës Nacional Çlirimtare dhe e periudhës së ndërtimit socialist, shtrihet në një plan të gjerë tematik. Në larminë e tematikës ajo u pasurua me një botkuptim fare të ri. Ajo, e frymëzuar nga mësimet e Partisë, për vlerësimin e ngjarjeve dhe qëllimeve të luftës Nacional Çlirimtare u udhëhoq në metodën e saj artistike nga principet e marksizëm-leninizmit. Vendosmëria për çlirimin e atdheut, lufta e pandërprerë dhe pa asnjë kompromis, çlirimi i klasës punëtore dhe i fshatarësisë, lufta për pushtetin popullor, puna dhe hovi për ndërtimin socialist, lufta kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, përbëjnë themelin ideor të epikës së luftës Nacional-Çlirimtare dhe të ndërtimit socialist.

Këto elemente tematike dhe njerëzit që vepruan dhe vepronë për t'i realizuar pa tjetër në trajtimin artistik të tyre, kërkonin edhe një metodë të re estetike. Ndjenjat e heroizmit, besimi në fitoren dhe t'ardhmen e socializmit dhe komunizmit, optimizmi triumfonjës dhe realist, janë tiparet kryesore si të ngjarjeve ashtu edhe të heroit, që luftoi dhe lufton për t'i realizuar idetë triumfonjëse të Partisë, që udhëhiqet nga idetë e Marksit-Engelsit-Leninist dhe Stalinit, karakteri i gjerë popullor i të gjithë procesit historik të luftës dhe të ndërtimit, janë tiparet kryesore të metodës së realizmit socialist. Këto përbëjnë figurën artistike edhe të Epikës së luftës nacional-çlirimtare edhe të periudhës së ndërtimit socialist.

R é s u m é

L'ÉPIQUE DE LA LUTTE DE LIBÉRATION NATIONALE ET DE L'ÉDIFICATION SOCIALISTE

Les chansons de la Lutte de Libération nationale ont pris naissance en deux étapes: La première, qui prend origine avec l'invasion fasciste et se termine le 29 Novembre 1944, se rattache directement aux événements de la Lutte de libération nationale; la deuxième, qui prend naissance au lendemain de la libération, se développe comme une évocation de l'épopée héroïque partisane en rattachant directement les liens du passé avec l'époque héroïque de l'édification du socialisme et de la défense du pays et du pouvoir populaire.

L'épique de la Lutte de Libération nationale s'est développée en pleine Lutte de Libération nationale, qui a eu lieu dans des conditions tout à fait différentes des guerres patriotiques soutenues dans le passé pour la liberté et l'indépendance. On assiste ainsi à un ancrage du motif proprement patriotique à celui socialo-politique, à mesure de la formation de la conscience politique du peuple albanais, avant et après la fondation du Parti communiste albanais. De son passé, notre peuple a conservé fidèlement un grand nombre de chansons populaires, qui deviennent autant de modèles d'inspiration pour des improvisateurs éminents et des poètes. Ces chansons étaient l'attestation principale de l'histoire guerrière de notre peuple, une histoire exprimée par des moyens artistiques. Elles ont servi de levain aux nouvelles compositions, en leur empruntant les meilleurs éléments révolutionnaires et patriotiques. C'est sur cette couche traditionnelle que s'amorce et se développe cette immense création populaire, qui se chiffre actuellement à plus de 2000 motifs.

La fondation du Parti communiste albanais a empreint à notre lutte patriotique, en même temps que le caractère anti-impérialiste, aussi celui révolutionnaire antiféodal, il a fait ranger notre pays du côté de la coalition antifasciste européenne. Cela fit enrichir notre épique de nouveaux éléments qualitatifs: les combattants prennent désormais un autre nom, partisans; ils luttent non seulement pour recouvrer la liberté mais aussi pour faire place nette de l'esclavage, ils luttent pour les deux classes principales, le prolétariat et la paysannerie. Ainsi, les chansons de la Lutte de Libération nationale servent consciemment à la cause du Parti et au but révolutionnaire du peuple, pour assurer l'avènement du pouvoir populaire. De ce phénomène qui véhiculait dans son évolution des éléments de guerre civile aussi, des éléments de révolution populaire, se fait jour un nouveau motif: celui de l'alliance de la classe ouvrière avec la paysannerie. Et cela est confirmé par un grand nombre de motifs.

Ainsi, les éléments de l'oppression sociale, qui véhiculaient l'écho des protestations anciennes contre la sujétion, sont traités sur un autre plan idéologique et simultanément artistique. Au caractère descriptif des souffrances du passé s'ajoute l'action héroïque révolutionnaire. Et ces changements qualitatifs représentent l'issue naturelle des principes du marxisme-léninisme de notre Parti dans la question de la libération à la fois nationale et sociale de nos travailleurs des villes et des campagnes.

Les partisans, afflués dans leur plus grande partie de la classe ouvrière et la paysannerie laborieuse, attirant dans leur voie aussi un grand nombre de patriotes des autres couches, font augmenter les effectifs de l'armée partisane. Ils sont conduits par le camarade Enver Hoxha, "les bombes dans la besace— jour et nuit dans le maquis"; les "bombes" de Kajan résonnent plus que les "canons de l'Allemand". En fait, la figure épique du partisan se situe à une

plus grande élévation spirituelle, du fait qu'il lutte dans d'autres conditions ; plus avancées, contre le tanket l'autoblinde. Le but élevé de la cause du parti et du peuple rend les partisans conscients. C'est ainsi que les chansons populaires ont enrichi les éléments anciens de nouveaux apports. La figure de la partisane Mali Pipa est une brillante généralisation épique: elle "n'a pas peur des balles, ne craint pas l'ennemi", mais attaque hautaine.

Le sujet de l'épopée de la Lutte de Libération nationale est très vaste. A différence du passé, quand notre peuple n'avait pas un appui solide pour sa lutte; cette fois il s'avantage de l'aide et du soutien fraternel de l'Union soviétique, conduite par Staline. Cette amitié tire sa source des sentiments d'internationalisme prolétarien, un des principes fondamentaux du marxisme-léninisme celui-ci.

Les engagements héroïques des divisions albanaises en territoire yougoslave constituent un sujet qui a trouvé son écho dans plusieurs chansons, comme celles des batailles de Drinško et de Vishegrad.

L'esprit anti-impérialiste de la chanson populaire fut enchevêtré et consolidé encore davantage par les motifs de la lutte contre la diversion révisionniste. Les chansons populaires de l'après-libération ont largement traité la lutte contre la diversion révisionniste, notamment celle yougoslave. Ainsi, les éléments de l'internationalisme prolétarien se sont exprimés parfaitement chez les chansons sur Memo Nexhipi, tué pendant la provocation d'août 1949, Xhemal Tafa, Abdul Merko, Tom Kola Zenel Kadria, Nuri Luçi, Ndreç Ndue Gjoka, et plusieurs autres.

Pendant la Lutte de Libération nationale sont tombés héroïquement 28 000 partisans. Leur souvenir occupe la place principale des motifs populaires: il s'agit d'une douleur générale, nationale, et en telle, elle déborde le strict cadre familial. Le caractère commun, généralisant, empreint des variations fondamentales aux élégies partisanes, qui tirent leur origine de la tâche à résoudre une question commune. Ce caractère commun apporte généralement une mutation foncière à la complainte, au planctus, le transforme en élégie. Il ne s'agit plus de pessimisme, mais de fierté. Chantons aux preux fait élever la douleur des souffrances qu'endurent les preux à un pathos épique, dont rarement pourrait nous donner un exemple toute littérature. Au-dessus de la douleur se situe un geste très haut, qui empreint à la chanson une mutation épique qualitative.

Un sujet nouveau pour les chansons populaires de la Lutte de libération nationale sont les événements historiques les plus saillants. De l'épique passée on a reçu quelque patrimoine à ce sujet, mais désormais l'on passe du caractère descriptif à celui programmatique, au motif mobilisant. Les événements politiques étant nombreux, aussi le nombre des chansons est grand: elles portent sur la fondation du Parti, la Conférence de Peze, le Congrès de Permet, les Congrès du Parti, et ainsi de suite. Comme on le voit, dans leur ensemble, aussi ces chansons expriment le caractère populaire de la Lutte de libération nationale et du pouvoir populaire.

Au cours de ces derniers 20 ans, l'Albanie en retard s'est transformée en un pays agricole-industriel. Ce nouvel état de choses exprime aussi le motif populaire. En traitant dans cet esprit la plupart des événements saillants. Désormais, le pathos épique révolutionnaire du motif de la Lutte de libération nationale, comme partie constitutive et très importante, se transforme en un pathos, au centre duquel se situe le travail de l'édification du socialisme. En raison des circonstances spéciales de l'édification socialiste, qui se réalise malgré le double encerclement impérialiste et révisionniste, les chansons de l'après-guerre visent la mobilisation au travail, à la défense du pays, des éléments ceux-ci qui s'enchevêtrèrent à des événements de conflits militaires aux frontières, ou bien se rat-

tachent directement aux nouveaux éléments que traite la chanson du travail. Les sujets, dans ce dernier cas, ne sont plus un enrichissement du patrimoine traditionnel: ils sont nouveaux, on a affaire à une nouvelle création. Ils sont un appel joyeux et optimiste, puisqu'ils chantent à l'édification du nouveau monde.

La chanson populaire a, comme activité sociale, un caractère de classe. Ses éléments paraissent chez plusieurs chansons du passé. Ils ont exprimé la lutte ferme contre l'étranger, et même, parfois, aussi l'aversion contre l'oppression intérieure. Ces éléments sociaux sont continuellement alimentés à mesure de la prise de conscience de la lutte des masses laborieuses contre l'oppression féodalo-bourgeoise. Cette idée de lutte de classe, et en général toute l'épopée de la Lutte de libération nationale, devient parfaitement efficace dans les conditions nouvelles: la chanson dirige sa pointe à raffermir la conscience révolutionnaire pour affranchir les masses du double joug étranger et intérieur (les classes exploitrices).

Les chansons de la Lutte de libération nationale et celles de l'après-guerre se sont enrichies d'une vaste thématique en raison du caractère extrêmement populaire de la lutte et de la révolution. Au point de vue thématique, elles appartiennent à l'épique citadine. Leur clarté politique, leur contenu solide, leur force épique, sont le reflet direct de l'idéologie marxiste-léniniste du Parti. En indiquant au peuple la voie de la révolution, le Parti lui a raffermi la conscience. Ainsi, comme épique citadine, elle s'inspire à l'idéologie du Parti, devient l'épique du Parti, c'est pourquoi la chanson assume une qualité nouvelle: celle de l'esprit du Parti.

Comme on le voit, la chanson épique de la Lutte de libération nationale et de la période de l'édification du socialisme comprend un vaste plan thématique. Inspirée aux enseignements du Parti, elle puise aux principes du marxisme-léninisme. La ferme décision à rendre libre le pays, la lutte incessante et sans compromis contre tout ennemi, l'affranchissement de la classe ouvrière et de la paysannerie, la lutte pour le pouvoir populaire, le travail et l'entraîn dans l'édification de la société socialiste, la lutte contre l'impérialisme et le révisionnisme moderne, voilà ce qui fait l'essence de l'idéologie de la chanson épique de la Lutte de Libération nationale et de l'édification du socialisme.